



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.12.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.12.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Avokat Ardita Morina” për aktivitetin: “Sherbimet e veçanta kontraktuale për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës” dhe me numër të prokurimit: 616 -19-8564-221 nxjerr:

### VENDIM

**1. Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Avokat Ardita Morina” e datës 23.12.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sherbimet e veçanta kontraktuale për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës” dhe me numër të prokurimit: 616 -19-8564-221, kundër Njoftimit *për Vendimin e AK-se për anulim të kontratës* të AK –së, të datës 18.12.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetet në fuqi Vendimi për anulim të kontratës** i publikuar me datë: 18.12.2019;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas Vendimit të datës 18.12.2019*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik “Avokat Ardita Morina” me datë 23.12.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sherbimet e veçanta kontraktuale për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës” dhe me numër të prokurimit: 616 -19-8564-221.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.12.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet për tenderuesin e propozuar për dhenje të kontratës:

-Pretendimi qe ka te beje me kualifikimet e stafit eshte plotesisht i pa bazuar pasi qe Autoriteti Kontraktues ne Vendimin per refuzimin e tenderit tuaj nuk ka permendur askund kete arsye;

-Pretendimi se ju keni plotesuar kriteret pasi qe Autoriteti Kontraktues ka kerkuar çmimin me te ulet e jo sipas tarifave dua t'ua perkujtoj se ju si anetare e Shoqates se Avokateve jeni te obliguar te zbatoni tarifat dhe Vendimet e te njejtës dhe poashtu duhet ta dini se qellimi kryesor i prokurimit eshte parimi i ekonomizimit respektivisht vlera per parane qe d.t.th.se kerkohet kryerja e puneve,sherbimeve dhe furnizimeve me çmime sa me te ulta.Ky parim eshte obligim ligjor per ne dhe duhet te respektohet,siqe eshte vepruar edhe ne kete rast.

Poashtu ua perkujtoj se ju nuk keni dorezuar Kerkesen per rishqyrtim nepermes paltformes elektronike.

Ne baze te sqarimeve paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Zyrtarja e prokurimit qe administron kete lende duhet te publikoj kete Vendim ne E Prokurim.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit